Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0055100-14/26
24.09.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-14/26 dt. 24.09.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi b dhe c, të Ligjit Nr. 03/L–040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 30, të Ligjit Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; Ligji Nr. 10/l-001 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 (GZ Nr. 04/2026,); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenin 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës; si dhe duke u bazuar në instruksionet e Ministrisë së financave, përkatësisht Departamentit të Buxhetit lidhur me respektimin e metodologjisë së transferimit, me qëllim të sigurimit të mjeteve për përfundimin e projektit të Rrugës Zhazhë -Vllahi, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 24.09.2026, pasi shqyrtoi Kërkesën Nr. 02-030/01-0052224/26 dt. 01.09.2026 Për transfer të mjeteve në investime kapitale, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0053079-7/26 dt. 15.09.2026); sjell këtë:

VENDIM
Për transfer të mjeteve financiare në investime kapitale

1. Miratohet Vendimi për transferin e mjeteve financiare të kategorisë së shpenzimeve kapitale, nga fondi burimor i Grandit (10) për programet\nënprogramet të ndikuara negativisht nga projektet:
   1.1 Nga 10/642/16322/300/53597/0133 – Administrata e përgjithshme, projekti "Rregullimi i objektit të Komunës" në shumë prej 15,000.00 (pesëmbëdhjetë mijë) €.
   1.2 Nga 10/642/17522/300/21019/0112 – Projekti "Rregullimi i Arkivës për dokumentacion financiar të Komunës" në shumë prej 30,000.00 (tridhjetëmijë) €.
   1.3 Nga 10/642/85022/300/20916/0820 – Shërbimet Kulturore, projekti "ndërtimi i objektit të muzeut" në shumë prej 75,000.00 (shtatëdhjetepesëmijë) €.
   1.4 Nga 10/642/92110/300/20810/0980 - Administrata e Arsimit, projekti "Ndërtimi i Shkollës Fillore 'Nonda Bulka" në shumë prej 50,000.00 (pesëdhjetëmijë) €.
   1.5 Nga 10/642/92110/300/53105/0980 - Administrata e Arsimit, Projekti "Rregullimi i objektit SHFMU Migjeni dhe pajisja me laborator", në shumë prej 30,000.00 (tridhjetëmijë) €.
2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij vendimi transferohen në programet/nënprogramet e ndikuara pozitivisht, gjegjësisht në projektin: 10/642/48022/300/56290/0411, Projekti "Ndërtimi i Rrugës Vllahi - Zhazhë, shuma e transferuar 200,000.00 (dyqind mijë) €.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe kërkesa tabelare e bashkangjitur këtij vendimi
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E MITROVICËS * OPŠTINA MITROVICA * REPUBLIKA KOSOVO * MITROVICE-MITROVICA

Dorëzohet:
1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha drejtorive

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo Finansije, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit-Budget Department-Budget Departament

KËRKESA PËR TRANSFER

PJESA 1: TË DHËNAT E TRANSFERIT

Emri i Organizatës Buxhetore	Komuna e Mitrovicës	Kodi	642
Emri i nën programit	Administrata Buxhetore, Planifikimi dhe Zhvillim Ekonomik, Shërbimet Kulturore dhe Administrata e Arsimit	Kodi	16322 17522 68022 85022 92110

Transferi/Rialokim

Kodi i organizatës	Kodi i nën programit	Kodi Funksional	Burimet e Financimit	Emërtimi i Projektit	Kodi i projektit	Kategoria shpenzimeve	Aprovimi i fundshem	Shuma e ndryshimit	Aprovimi i ri	Buxheti Aprovuar/Rishikuar	Totali i shumës së transferuar/rialokuar	Të Transferoni Rialokimi (+/-) në ndaj buxhetit
642			10				560,000.00	-	560,000.00	560,000.00	-	-
642	16322	0131	10	ADMINISTRATA			100,000.00	(15,000.00)	85,000.00	100,000.00	(15,000.00)	(15.00)
642	17522	0112	10+21	BUXHETIMI			258,389.00	(30,000.00)	228,389.00	258,389.00	(30,000.00)	(11.61)
642	85022	0810	10	SHËRBIMET KULTURORE			500,000.00	(75,000.00)	425,000.00	500,000.00	(75,000.00)	(15.00)
642	92110	0980	10+21	ADMINISTRATA ARSIMIT			1,315,000.00	(80,000.00)	1,135,000.00	1,315,000.00	(80,000.00)	(6.08)

PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË TRANSFERUAR

		PO	JO
(Shëno Po osë Jo)	Transferi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve	PO	
	Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rjadhës së parasë?	PO	

PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)

Projekti "Ndërtimi i rrugës Zhazh-Vllahi" është në vazhdim të punimeve dhe aktualisht ndodhet në fazën përfundimtare të realizimit. Bazamenti dhe struktura e rrugës janë formësuar dhe punuar në tërësi, ndërsa ka mbetur vetëm finalizimi i punimeve, përkatësisht asfaltimi i rrugës së lartcekur.
Duke qenë se projekti ndodhet në fazën finale të realizimit, përfundimi i tij brenda vitit fiskal 2026 është i një rëndësie të veçantë, veçanërisht duke marrë parasysh pozitën gjeografike të rrugës, e cila shtrihet në pjesën veriore të territorit të komunës së Mitrovicës dhe krijon një lidhje të rëndësishme rrugore për qytetarët dhe zonat përreth.
Po ashtu, duke marrë parasysh karakterin kodrinor-malor të terrenit dhe kushtet atmosferike gjatë sezonit të dimrit, është e rëndësishme që shtresa e përfundimit të rrugës të finalizohet me asfaltim sa më parë. Reshjet, ngrirjet, shkarjet e borës dhe qarkullimi i mjeteve mund të shkaktojnë dëmtimin dhe degradimin e bazës së përgatitur të rrugës, duke krijuar nevojë për ndërhyrje dhe riparime shtesë, si dhe kosto shtesë para realizimit të asfaltimit.
Për këto arsye, sigurimi i mjeteve të nevojshme financiare dhe përfundimi i asfaltimit brenda vitit fiskal 2026 janë të rëndësishme jo vetëm për përmbushjen e kontratës dhe realizimin e plotë të projektit, por edhe për ruajtjen e investimit të realizuar deri më tani, parandalimin e dëmtimeve të bazës së rrugës dhe garantimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës në funksionalitetit të saj afatgjatë.

TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

Zyrtari kryesor financiar	Data	Zyrtari Kryesor Administrativ / Kryeshefi Ekzekutiv	Data
Zenel Çitaku	01.09.2026	Falon PECI	01.09.2026

PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI

ANALIZA E MFPT (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)

KËRKO NDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE		NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA*	
Drejtor i Buxhetit	Data	Departamenti i buxhetit regjistrimit i të dhënave*	Data
Salvador Elmazi		NUMRAT E KD	
Nënshkrim			